



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 14

Instrumentet financiare

Qëllimi

Qëllimi i këtij standardi është që t'i vendosë parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpaltosjen e informatave rreth instrumenteve financiare në pasqyrat financiare të ndërmarrjeve.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të përdoret nga të gjitha ndërmarrjet për të gjitha instrumentet financiare përveç:
 - (a) të drejtave dhe obligimeve nën lizing (shih SKK 13 “Lizingët”)
 - (b) instrumenteve të ekuitetit të lëshuara nga entiteti raportues
 - (c) kontratave garantuese financiare, përfshirë letrat kreditore që sigurojnë pagesat për t'u bërë nëse borxhliu dështon që ta kryejë pagesën që kur i vjen afati (SKK 17 “Provizionet, detyrimet kontingjente, pasuritë kontingjente” siguron udhëzim për njohjen dhe matjen e garancive financiare dhe instrumenteve të tjera të ngjashme)

Përkufizimet

2. Shprehjet vijuese përdoren në këtë standard me këto kuptime të caktuara:

Instrument financiar është çdo kontratë që i rrit të dyja: pasurinë financiare të një ndërmarrjeje dhe detyrimin financiar ose instrumentin e ekuitetit të ndërmarrjes tjetër.

Pasuri financiare është çdo pasuri siç janë:

- (a) Paratë e gatshme
- (b) E drejta kontraktuese për të pranuar kesh ose pasuri tjetër financiare nga ndërmarrja tjetër
- (c) E drejta kontraktuese për t'i këmbyer instrumentet financiare me ndërmarrjen tjetër në kushtet që janë potencialisht të favorshme, ose
- (d) Instrumenti i ekuitetit të ndërmarrjes tjetër.

Shprehjet “kontrata” dhe “kontraktues” i referohen një marrëveshje midis dy ose më shumë palëve që kanë pasoja të qarta ekonomike që palët kanë pak, nëse ka ndonjë, zgjedhje për të shmangur, zakonisht sepse marrëveshja është e detyrueshme me ligj. Pasuritë fizike siç janë inventari, patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet, pasuritë lizing dhe pasuritë e paprekshme si patentet nuk janë pasuri financiare. Pasuritë siç janë shpenzimet e parapaguara, për të cilat dobia ekonomike në të ardhmen është pranimiti i mallrave ose shërbimeve më tepër se e drejta për të pranuar para të gatshme ose pasuri tjetër financiare, nuk janë pasuri financiare.

Obligimi financiar është çdo obligim që është obligim kontraktues:

- (a) për t'i dhënë kesh ose një pasuri tjetër financiare ndërmarrjes tjetër, ose
- (b) për t'i këmbyer instrumentet financiare me një ndërmarrje tjetër me kushte që janë potencialisht të pafavorshme.

Detyrimet që nuk janë kontraktuese sipas llojit, siç janë tatimet mbi fitimin që krijohen si rezultat i kërkesave ligjore të caktuara nga qeveria, nuk janë detyrime financiare.

Instrument ekuiteti është çdo kontratë që evidencon kamatën të mbetur në pasuritë e ndërmarrjes pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj.

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare monetare janë instrumentet financiare që do të pranohen ose paguhen në shuma fikse ose të përcaktuara të parasë.

Vlera fer është shuma për të cilën një pasuri mund të këmbehet, ose detyrimi të përcaktohet përfundimisht, midis palëve në mënyrë të vetëdijshme dhe të vullnetshme në një transaksion duarlibër.

Transaksioni duarlibër është transaksioni midis palëve jo të lidhura, ku secili vepron sipas interesit vetjak.

Vlera e tregut është shuma e marrë nga shitja - ose e pagueshme gjatë marrjes - të instrumentit financiar në një treg aktiv.

Përkufizimet për llojet e zakonshme të instrumenteve financiare, pasurisë financiare dhe detyimeve financiare

3. Paraja e gatshme është pasuri financiare, sepse ajo e pasqyron mjetin e këmbimit dhe së këndejmi është bazë, mbi të cilën të gjitha transaksionet maten dhe paraqiten në pasqyrat financiare. Depoziti në para të gatshme në një bankë ose institucion të ngjashëm financiar është pasuri financiare, sepse paraqet të drejtën kontraktuese të depozitorit për të marrë para të gatshme nga institucioni.
4. Shembuj të zakonshëm të pasurive financiare që paraqesin të drejta kontraktuese për të pranuar para të gatshme në të ardhmen dhe detyrimet financiare korresponduese që paraqesin obligim kontraktues për të dhënë para të gatshme në të ardhmen janë:
 - (a) kontot e arkëtueshme dhe të pagueshme të tregëtisë
 - (b) vërtetimet e të arkëtueshmve dhe të pagueshmeve
 - (c) të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e huasë

Në çdo rast, një e drejtë kontraktuese e palës për të pranuar (ose obligim për të paguar) para të gatshme barazohet me obligimin korrespondues të palës tjetër për të paguar (ose e drejtë për të pranuar).

5. Sipas SKK 13 “Lizingët” lizingu financiar llogaritet si shitje me afat pagese të shtyrë. Lizingu financiar konsiderohet të jetë instrument financiar, kurse lizingu operues nuk konsiderohet të jetë instrument financiar (përveç kur u përket pagesave individuale në rrjedhje e sipër dhe të pagueshme).

6. Është relativisht lehtë për emetuesit që të klasifikojnë lloje të caktuara të instrumenteve financiare si detyrime ose ekuitet. Shembuj e instrumenteve të ekuitetit i përfshijnë aksionet e zakonshme dhe aksionet me prioritet. Aksionet e zakonshme nuk e obligojnë emetuesin për t'ia transferuar pasuritë aksionarit, përveç kur emetuesi vepron formalisht për ta bërë shpërndarjen dhe bëhet me ligj i obliguar ndaj aksionarëve të bëjë ashtu. Një shembull i kësaj është deklarimi i dividendit.

Përkufizimet për kategoritë e pasurive financiare

7. **Pasuria ose detyrimi financiar të mbajtura për tregti** është një gjë që arrihet ose ndodh kryesisht për qëllime të krijimit të fitimit nga lëvizjet afatshkurtëra në çmime. Pasuria financiare duhet të klasifikohet se mbahet për tregti, pavarësisht se si fitohet, nëse ajo është pjesë e portfolios për të cilën ekziston evidenca e modelit aktual e marrjes së fitimit afatshkurtër.

Investimet e mbajtura deri në skadim janë pasuritë financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me skadim fiks që një ndërmarrje ka synim pozitiv dhe aftësi për t'i mbajtur deri në skadim, ndryshe nga huatë dhe të arkëtueshmet e krijuara nga ndërmarrja.

Huatë dhe kërkesat e krijuara nga ndërmarrja janë pasuritë financiare që krijohen nga ndërmarrja duke siguruar para, mallra ose shërbime drejtpërdrejt për borxhliun. Huatë dhe të arkëtueshme e krijuara nga ndërmarrja nuk përfshihen në investimet e mbajtura deri në skadim por më shumë, klasifikohen ndarazi sipas këtij standardi.

Pasuritë financiare të gatshme për shitje janë ato pasuri financiare që nuk janë (a) hua dhe të arkëtueshme të krijuara nga ndërmarrja, (b) investime të mbajtura deri në skadim ose (c) pasuri financiare të mbajtura për tregti.

Përkufizimet lidhur me njohjen dhe matjen

8. **Shpenzimi i amortizuar i pasurisë financiare ose të detyrimit financiar** është shuma në të cilën është matur pasuria financiare dhe detyrimi financiar në njohjen fillestare minus pagesa e ekuitetit, plus ose minus amortizimi kumulativ i çdo ndryshimi midis asaj shume fillestare dhe shumës në afatin e skadimit dhe minus çfarëdo zbritjeje (drejtpërdrejtë ose nëpërmes përdorimit të një llogarie zbritëse) për dëm ose paarkëtueshmëri.

Metoda efektive e interesit është metodë e kalkulimit të amortizimit duke e përdorur normën efektive të kamatës së pasurisë financiare ose të detyrimit financiar. Norma efektive e kamatës është norma që saktësisht

diskonton nivelin e pritur të pagesave me para të gatshme në të ardhmen nëpërmjet afatit të skadimit - deri tek vlera neto kurrente e regjistrimit - të pasurisë financiare ose detyrimit financiar. Ajo llogaritje duhet t'i përfshijë të gjitha tarifat e paguara (provizionet) e paguara ose të pranuar midis palëve të kontratës.

Kostot e transaksionit janë kostot shtesë që i shtohen drejtpërdrejt marrjes ose heqjes nga pëdorimi të një pasurie apo detyrimi financiar.

Zotimi i firmës është marrëveshja detyruese për këmbim të një sasive të caktuar të resurseve me çmim të caktuar më datën ose datat e caktuara në të ardhmen.

Kontrolli i një pasurie është fuqia për të arritur dobi ekonomike në të ardhmen të cilat rrjedhin nga pasuria.

Mosnjohja nënkupton mënjanimin e pasurisë ose detyrimit financiar, ose një pjesë të pasurisë ose detyrimit financiar, nga pasqyra e bilancit të ndërmarrjes.

Prezantimi

9. Emetuesi i instrumentit financiar duhet të klasifikojë instrumentin ose pjesët përbërëse të tij, si një pasuri, detyrim ose ekuitet konform me substancën e aranzhimit kontraktues të njohjes fillestare dhe me përkufizimet e pasurisë financiare, detyrimit dhe instrumentit të ekuitetit.

Njohja

Njohja fillestare

10. Ndërmarrja duhet ta njohë pasurinë financiare ose detyrimin financiar në pasqyrën e bilancit të vet atëherë dhe vetëm atëherë, kur ajo bëhet palë në dispozitat kontraktuese të instrumentit.
11. Në vazhdim ipen disa shembuj të aplikimit të parimeve të njohjes:
 - (a) Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e pakushtëzuara njihen si pasuri ose detyrim, kur ndërmarrja bëhet palë në kontratë dhe, për pasojë, ka të drejtë ligjore për të pranuar para të gatshme ose obligim ligjor për të paguar para të gatshme.
 - (b) Pasuritë për t'u marrë dhe detyrimet që do të vijnë si rezultat i zotimit për blerë ose për të shitur mallra ose shërbime, nuk njihen sipas praktikës së tashme të kontabilitetit, derisa së paku njëra nga palët ta kryejë, sipas marrëveshjes. Për shembull një ndërmarrje që

pranon porosinë e firmës nuk e njej pasurinë (dhe ndërmarrja që shtron porosinë nuk e njej detyrimin) në kohën e detyrimit por, për më tepër, njohje e shtyrë derisa mallrat ose shërbimet e porositura të transportohen, dërgohen ose kryhen.

- (c) Transaksionet e planifikuara në të ardhmen, pa marrë parasysh si duken, nuk janë pasuri dhe detyrime të një ndërmarrjeje që kur ndërmarrja, më datën e raportimit financiar, nuk është bërë palë e kontratës duke kërkuar pranimin ose dorëzimin në të ardhmen të pasurive që krijohen jashtë transaksioneve të ardhshme.

Data e tregtimit

12. Kontrata për blerjen ose shitjen e pasurive financiare që kërkon dorëzimin e pasurive brenda afatit kohor të përcaktuar në përgjithësi nga rregullorja ose konventës në treg, është instrument financiar.
13. Data e tregtimit është data, e cila zoton ndërmarrjen për të blerë ose shitur një pasuri. Data e tregtimit në kontabilitet i referohet (a) blerësit, njohja e pasurisë së pranuar dhe e detyrimit për t'u paguar për atë në datën e tregtimit dhe (b) shitësit, mosnjohja e pasurisë që është shitur dhe njohja e së arkëtueshmes nga blerësi për pagesën më datë të tregtimit. Në përgjithësi, interesi nuk fillon të përlogaritet (akruar) në pasurinë dhe detyrimin korrespondues, deri më datë e përcaktimit përfundimtar kur kjo e drejtë njihet. Data e përcaktimit përfundimtar është data kur pasuria i dorëzohet ndërmarrjes ose dorëzohet nga ndërmarrja.

Shembull i datës së tregtimit në kontabilitet

Ky shembull e ilustron aplikimin e datës së tregtimit në kontabilitet dhe pjesët e mëvonshme të këtij standardi që e specifikon matjen dhe njohjen e ndryshimeve në vlerat fer për lloje të ndryshme të pasurive financiare. Më 20 dhjetor 2001, ndërmarrja zotohet për blerjen e pasurisë financiare prej 1.000, e cila është vlera e tij fer në datën e zotimit (tregtimit). Më 31 dhjetor 2001 (fundi i vitit financiar) dhe më 4 janar 2002 (data e përcaktimit përfundimtar) vlera fer e pasurisë është përkatësisht 1.002 dhe 1.003. Shumat që do të regjistrohen për pasuri, do të varen se si klasifikohen siç tregohet në tabelën më poshtë:

Balanci	Investimet e mbajtura deri në skadim: të bartura në koston e amortizuar	Pasuritë e mbajtura për tregti dhe pasuritë egatshme për shitje	pasuritë: të rimatura në vlerën fer
29 dhjetor 20x1			
Pasuria financiare	1,000	1,000	1,000
Detyrimi financiar	(1000)	(1000)	(1000)
31 dhjetor 20x1			
Te arketueshmet	--	--	--
Pasuria financiare	1,000	1,002	1,002
Detyrimi	(1,000)	(1,000)	(1,000)
Ekuiteti (vlera fer)	--	(2)	--
Fitimet e pashpërndara (përmes fitimit ose humbjes neto)	--	--	2
4 Janar 20x2			
Te arketueshmet	--	--	--
Pasuria financiare	1,000	1,003	1,003
Detyrimet	--	--	--
Ekuiteti (ndryshimet fer te vleres)	--	(3)	--
Fitimet e pashpërndara (përmes fitimit ose humbjes neto)	--	--	--

Mosnjohja

14. Ndërmarrja duhet që të mosnjoh pasurinë financiare ose pjesën e pasurisë financiare atëherë dhe vetëm atëherë, kur ndërmarrja e humb kontrollin e të drejtave kontraktuese që përbëjnë pasurinë financiare. Ndërmarrja e humb kontrollin e tillë nëse realizon të drejtën për dobi të caktuar në kontratë, ose këtyre të drejtave u kalon afati, ose kur ndërmarrja ia kalon tjetrit këto të drejta.
15. Përcaktimi se kur e ka humbur ndërmarrja kontrollin e pasurisë financiare varet edhe nga pozita e ndërmarrjes edhe ajo e bartësit. Rrjedhimisht, nëse pozita e secilës ndërmarrje tregon se transferuesi ka mbajtur kontroll, transferuesi nuk duhet ta mënjanojë nga pasqyra e bilancit të vet.
16. Transferuesi e ka humbur kontrollin e pasurisë financiare të transferuar, vetëm nëse bartësi ka aftësi për të arritur përfitime nga pasuria e transferuar.
17. Te mosnjohja, ndryshimi midis (a) shumës së regjistrimit të pasurisë së transferuar tek pala tjetër dhe (b) paratë e gatshme të pranuar ose të arkëtueshmet, duhet të përfshihen në fitimin neto ose në humbje për periudhën.

Mosnjohja e detyrimit financiar

18. Ndërmarrja duhet ta mënjanojë detyrimin financiar (ose pjesën e detyrimit financiar) nga pasqyra e bilanci të vet atëherë dhe vetëm atëherë, kur detyrimi i caktuar në kontratë shlyhet, anulohet ose **skadon**.
19. Kushti për mosnjohje plotësohet kur:
 - (a) borxhliu e shlyen detyrimin duke e paguar huadhënësinë, ose
 - (b) borxhliu zyrtarisht lirohet nga përgjegjësia primare e detyrimit ose nëpërmes procesit të ligjit ose nga ana e huadhënësitë.
20. Huamarrësi dhe huadhënësi mund të pajtohen për ndryshimin e kushteve të një instrumenti ekzistues të borxhit. Modifikimi substancial i kushteve të një instrumenti ekzistues të borxhit (qoftë për shkak të vështirësive financiare ose jo të borxhliut) duhet të llogaritet si shuarje e borxhit të vjetër. Shuarja e borxhit të vjetër duhet të rezultojë nga mosnjohja e atij borxhi dhe njohja e instrumentit të ri të borxhit.
21. Nëse këmbimi i instrumenteve ose modifikimi i kushteve regjistrohen si shuarje, çdo kosto apo tarifë e ndodhur njihet si pjesë e fitimit ose humbje gjatë shuarjes. Nëse modifikimi i kushteve nuk është substancial, ai nuk konsiderohet shuarje. Në atë rast, çdo kosto apo tarifë janë harmonizim i

shumës së regjistrimit të obligimit dhe amortizohet gjatë afatit të mbajtur të kredisë së modifikuar.

22. Ndryshimi midis shumës së regjistrimit të detyrimit që është shuar, duke përfshirë kostot përkatëse të paamortizuara dhe shumën e paguar për atë që duhet të përfshihet në fitimin ose në humbje neto për periudhën.

Interesi, dividendet, humbjet dhe fitimet

23. Interesi, dividendët, humbjet dhe fitimet lidhur me instrumentet financiare të klasifikuara, duhet të raportohen në pasqyrën e të ardhurave. Shpërndarjet për mbajtësit e instrumentit financiar që klasifikohet si instrument ekuiteti duhet të debitohen nga emetuesi drejtpërdrejt në ekuitet.

Kundërpeshimi i pasurisë financiare dhe detyrimit financiar

24. Pasuria financiare dhe detyrimi financiar duhet vetëm të kundërpeshohen dhe vlera neto të raportohet në pasqyrën e bilancit kur ndërmarrja:
- (a) ka të drejtë ligjore detyruese për t'i kundërpeshuar shumat e njohura; dhe
 - (b) vendos që të përcaktohet përfundimisht mbi bazën neto, ose realizon pasurinë dhe njëkohësisht e përcakton përfundimisht detyrimin.
25. Kur ndërmarrja ka të drejtë që ta pranojë ose ta paguajë një shumë të vetme neto dhe dëshiron që të veprojë ashtu, ajo ka ç'është e vërteta, vetëm një pasuri financiare ose një detyrim financiar të vetëm. Në mënyrë që kundërpeshimi të jetë i përshtatshëm, pasuria dhe detyrimi duhet të përcaktohen përmes pagesës së një shume të vetme neto. Nuk është e përshtatshme për një entitet që të kundërpeshojë një konto të pagueshme dhe një konto të arkëtueshme me ndonjë entitet tjetër, nëse pasuria dhe detyrimi do të përcaktohen me këmbime të ndara, madje edhe nëse ato ndodhin në të njëjtën kohë.
26. Kushtet për kundërpeshim nuk janë të kënaqshme dhe kundërpeshimi është i papërshtatshëm kur obligimet që do të rezultojnë me humbje, pritet të mbulohen nga pala e tretë me polisën e sigurimit.

Matja

Matja fillestare e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare

27. Kur pasuria financiare ose detyrimi financiar njihen fillimisht, ndërmarrja duhet ta masë me çmimin e saj, i cili është vlera fer e vlerësimit të dhënë (në rastin e pasurisë) ose të pranuar (në rastin e detyrimit) për të. Shpenzimet e transaksionit përfshihen në matjen fillestare të të gjitha pasurive dhe detyrimeve financiare.

Matja pasuese e pasurive financiare

28. Për qëllimet e matjes së pasurisë financiare që e ndjek njohjen fillestare, pasuritë financiare ky standard i klasifikon në katër kategori:
- (a) huatë dhe të arkëtueshmet e krijuara nga ndërmarrja dhe që nuk mbahen për tregti
 - (b) investimet e mbajtura deri në skadim
 - (c) pasuritë financiare të gatshme për shitje, dhe
 - (d) pasuritë financiare që mbahen për tregti.
29. Pas njohjes fillestare, ndërmarrja duhet t'i masë pasuritë financiare në vazhdim në vlerat fer të tyre, pa ndonjë zbritje për kostot e transaksionit që mund të krijohen me shitjen ose me heqjen tjetër nga përdorimi tjetër:
- (a) pasuritë financiare që mbahen për tregti
 - (b) pasuritë financiare të gatshme për shitje
- Megjithatë, çdo pasuri financiare që nuk ka çmim të caktuar të tregut në një treg aktiv dhe vlera fer e së cilës nuk mund të matet me besueshmëri, nuk matet në vlerën fer.
30. Llojet e pasurive financiare në vazhdim nuk maten me vlerën fer por maten sipas kostos së amortizuar:
- (c) huatë dhe të arkëtueshmet e krijuara nga ndërmarrja e që nuk mbahen për tregti
 - (d) investimet e mbajtura deri në skadim, dhe
 - (e) çdo pasuri financiare që nuk ka çmim të caktuar të tregut në një treg aktiv dhe vlera fer e së cilës nuk mund të matet në mënyrë të besueshme.
31. Ato pasuri financiare që përjashtohen nga vlerësimi fer dhe që kanë skadim fiks duhet të maten me koston e amortizimit duke përdorur

metodën efektive të shkallës së interesit. Ato që nuk kanë skadim fiks, duhet të maten sipas kostos. Të gjitha pasuritë financiare janë subjekt për shqyrtim të dëmit.

32. Supozohet se vlera fer mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme për shumicën e pasurive financiare të klasifikuara si të gatshme për shitje ose të mbajtura për tregti. Megjithatë, ky supozim mund të vlejë në shprehje për investim të një instrumenti që nuk ka çmim të caktuar të tregut në një treg aktiv dhe për të cilin metodat e tjera të arsyeshme për vlerësimin e vlerës fer janë qartazi të papërshtatshme ose jofunksionale.
33. Të arkëtueshmet afatshkurtra pa shkallë të caktuar interesi normalisht maten në shumën origjinale të faturës.
34. Huatë dhe të arkëtueshmet e krijuara nga ndërmarrja dhe që s'mbahen për tregëti, maten në koston e amortizimit pa marrë parasysh qëllimin e ndërmarrjes që t'i mbajë ato deri në skadim.
35. Ndërmarrja aplikon - SKK 11 “Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit” - për pasuritë financiare që janë zëra monetare sipas SKK 11 dhe që janë të emërtuar në valutë të huaj. Çdo fitim dhe humbje e kursit të këmbimit në pasuri monetare raportohet në fitimin ose humbje neto për periudhën kur ndodh ajo. Çdo ndryshim i njohur në vlerën fer të zërit të tillë monetar pavarësisht nga fitimi dhe humbja në kurs të këmbimit, po ashtu, llogaritet në fitimin ose humbje neto për periudhën kur ndodh ajo. Lidhur me pasuritë financiare jomonetare si instrumente të ekuitetit, çdo ndryshim i njohur në vlerën fer regjistrohet në fitimin ose humbjen neto.

Investimet e mbajtura deri në skadim

36. Investimet e mbajtura deri në skadim janë pasuritë financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me skadim fiks, me ç'rast ndërmarrja ka synim pozitiv dhe mundësi për t'i mbajtur deri në skadim, ndryshe nga huatë dhe të arkëtueshmet e krijuara nga ndërmarrja.
37. Ndërmarrja nuk ka synim pozitiv për ta mbajtur investimin deri në skadim një pasuri financiare me skadim fiks, nëse përmbushet ndonjëri nga këto kushte:
 - (a) ndërmarrja ka synim për ta mbajtur pasurinë financiare vetëm për një periudhë të pacaktuar
 - (b) ndërmarrja është e gatshme për ta shitur pasurinë financiare si përgjigje ndaj ndryshimeve në shkallët e interesit ose rreziqeve në treg, nevojave të likuiditetit, ndryshimeve në burimet dhe afatet financiare, ose ndryshimeve në rrezikun e valutës së huaj.

38. Shumica e letrave me vlerë të ekuitetit (si aksionet e zakonshme) nuk mund të mbahen derisa të skadojnë investimet, sepse ato kanë afat të pacaktuar. Lidhur me investimet e mbajtura deri në skadim, pagesat fikse ose të përcaktueshme dhe skadimi fiks nënkuptojnë aranzhimet kontraktuese që i përcaktojnë shumat dhe datat e pagesave për mbajtësin, siç janë interesi dhe pagesat e kryegjës së borxhit.
39. Ndërmarrja nuk ka demonstruar aftësi për ta mbajtur investimin deri në skadim në një pasuri financiare me skadim fiks, nëse nuk plotësohen ndonjëri prej kushteve vijuese:
- (a) nëse nuk ka burime financiare të gatshme për ta vazhduar financimin e investimit deri në skadim, ose
 - (b) ai i nënshtrohet ndonjë kufizimi ekzistues ligjor ose ndonjë kufizimi tjetër që mund ta pengojë qëllimin e tij për ta mbajtur pasurinë financiare deri në skadim.
40. Ndërmarrja e vlerëson synimin dhe aftësinë e saj për t'i mbajtur investimet e mbajtura deri në skadim jo vetëm kur këto pasuri financiare merren në fillim, por po ashtu, në secilën datë të pasqyrës së bilancit.
41. Nëse, për shkak të ndryshimit të synimit apo aftësisë, më nuk është e përshtatshme për t'i regjistruar investimet me koston e amortizuar, ato duhet të rimaten në vlerën fer dhe ndryshimi midis shumës së regjistrimit dhe vlerës fer duhet të llogaritet në fitimin ose humbjen neto për periudhën kur ka ndodhur rimatja.
42. Njësoj, nëse matja e besueshme e vlerës fer vihet në dispozicion për pasuri financiare për të cilën matja e tillë e mëparshme nuk ishte në dispozicion, pasuria duhet të rimatet në vlerën fer dhe ndryshimi midis shumës së regjistrimit dhe vlerës fer duhet të llogaritet në fitimin ose humbjen neto, për periudhën kur ka ndodhur rimatja.
43. Nëse, për shkak të ndryshimit të synimit ose aftësisë, bëhet më e përshtatshme për ta regjistruar pasurinë financiare në koston e amortizimit më tepër se në vlerën fer, vlera fer e shumës së regjistrimit të pasurisë financiare në atë datë bëhet kosto e re e amortizimit të saj.

Matja pasuese e detyrimeve financiare

44. Pas njohjes fillestare, ndërmarrja duhet t'i masë të gjitha detyrimet financiare, ndryshe nga detyrimet e mbajtura për tregti, në koston e amortizimit.

45. Ndërmarrja aplikon - SKK 11 "Efektet e ndryshimeve në kurste e këmbimit në valutë të huaj" - për detyrimet financiare që janë monetare sipas SKK 1 dhe që janë të emëtuara në valutë të huaj. Sipas SKK 11, çdo fitim ose humbje në kurs të këmbimit për detyrimet monetare raportohet në fitimin ose humbje neto. Çdo ndryshim i njohur në vlerën fer të zërit të tillë pavarësisht nga fitimet dhe humbjet në kurs të këmbimit llogaritet në fitimin ose humbjen neto.

Konsideratat e matjes së vlerës fer

46. Vlera fer e instrumentit financiar është e matshme në mënyrë të besueshme (a) nëse ndryshueshmëria e radhitjes së vlerësimit të arsyeshëm të vlerës fer nuk është e rëndësishme për atë instrument ose (b) nëse mundësia e vlerësimeve të ndryshme brenda radhës mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoret në vlerësimin e vlerës fer. Ndërmarrja shpesh do të jetë e aftë për të bërë vlerësimin e supozuar të vlerës fer të instrumentit financiar që është mjaft i besueshëm për ta përdorur në pasqyrat financiare. Përdorimi i vlerësimeve të supozuara të arsyeshme është një pjesë esenciale e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nuk e prish besueshmërinë e tyre. Megjithatë, në mungesë të tregut të zhvilluar për instrumentet financiare, vlerësimet e supozuara të vlerës fer mund të jenë aq të vështira për të vlerësuar sa mohohet dobishmëria e një vlerësimi të supozuar të vetëm të vlerës fer.
47. Situatatat, në cilat vlera fer është e matshme në mënyrë të besueshme, përfshijnë (a) instrumentin financiar për të cilin ekziston caktimi i çmimit që publikohet dhe tregun aktiv publik të letrave me vlerë për atë instrument (b) instrumentin e borxhit që është klasifikuar nga agjencia klasifikuese e pavarur dhe rrjedha e parasë të të cilit mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe (c) instrumenti financiar për të cilin ekziston modeli i përshtatshëm i vlerësimit dhe për të cilin të dhënat hyrëse të atij modeli mund të maten me besueshmëri, pasi të dhënat vijnë nga tregu aktiv.

Fitimet dhe humbjet gjatë rimatjes së vlerës fer

48. Fitimi ose humbja e njohur që rrjedh nga ndryshimi në vlerën fer të pasurive financiare ose detyrimit financiar duhet të raportohet në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën krijohet.
49. Për arsye se paraqitja e pasurisë financiare e mbajtur për tregti bazohet në qëllimin për ta marrë atë fillimisht, ndërmarrja nuk duhet ta riklasifikojë pasuritë e saj financiare që janë rimatur në vlerën fer jashtë kategorisë së tregtisë, derisa janë mbajtur ato. Pasuritë financiare ndërmarrja duhet ta riklasifikojë në kategori të tregtimit vetëm nëse ekziston evidenca e modelit aktual të marrjes së fitimit afatshkurtër që e arsyeton riklasifikimin e tillë.

Fitimet dhe humbjet në pasuritë dhe detyrimet financiare që nuk janë rimatur në vlerën fer

50. Për ato pasuri dhe detyrime financiare që regjistrohen në koston e amortizimit, fitimi ose humbja njihen në fitimin ose humbjen neto, kur pasuria ose detyrimi financiar shuhet ose dëmtohet, si dhe përmes procesit të amortizimit.

Dëmtimi dhe paarkëtueshmëria e pasurive financiare

51. Pasuria financiare dëmtohet nëse shuma e regjistrimit të saj është më e lartë se sa vlera e supozuar e shumës së rikuperueshme. Ndërmarrja duhet të vlerësojë në secilën datë të pasqyrës bilancit pa marrë parasysh se a ekziston ndonjë evidencë objektive që një pasuri financiare ose grupi i pasurive mund të dëmtohen. Nëse ekziston ndonjë evidencë e tillë, ndërmarrja duhet ta bëjë vlerësimin e supozuar të vlerës së rikuperueshme të asaj pasurie ose të grupit të pasurive dhe ta njohë ndonjë humbje të dëmit në fitimin ose humbjen neto për periudhën.
52. Evidenca objektive se pasuria financiare ose grupi i pasurive është i dëmtuar ose i paarkëtueshëm përfshin informacionin që është si vërejtje për mbajtësin e pasurisë për:
- (a) vështirësisë së madhe financiare të emetuesit
 - (b) prishjen aktuale të kontratës, siç është mospagesa ose gabimi në pagesat e interesit ose kryegjësë
 - (c) probabiliteti i lartë i falimentimit ose ndonjë riorganizim financiar tjetër i emetuesit
 - (d) modeli historik i arkëtimit të kontove të arkëtueshme që tregojnë se vlera e tërësishme nominale e portfolios së kontove të arkëtueshme nuk do të arkëtohet.

Pasuria financiare e bartur në koston e amortizimit

53. Nëse është e besueshme se ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje për të arkëtuar të gjitha shumat e pritura (kryegjënë dhe interesin) duke u bazuar në kushtet kontraktuese të huave, të arkëtueshme ose të investimeve të mbajtura deri në skadim të regjistruara në koston e amortizimit, ndodh dëmi ose humbja e borxhit të keq. Shuma e humbjes është ndryshimi midis shumës së regjistrimit të pasurisë dhe shumës së rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera e tashme e rrjedhës së parasë të pritur në të ardhmen e diskontuar në shkallën efektive origjinale të

- interesit të instrumentit financiar. Rrjedha e parasë që u përket të arkëtueshmeve afatshkurtëra nuk diskontohej. Shuma e regjistrimit të pasurisë duhet të zbritet tek shuma e rikuperueshme e vlerësimit të supozuar të saj ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie shtesë. Shuma e humbjes duhet të përfshihet në fitmin ose humbjen neto për periudhën.
54. Dëmi dhe joarkëtueshmëria maten dhe njihen veç e veç për pasuritë financiare që janë të mëdha një nga një. Dëmi dhe joarkëtueshmëria mund të maten dhe njihen në bazë të portfolios për grupin e pasurive financiare të ngjashme që nuk identifikohen veç e veç si dëm.
55. Kredituesi mund ta masë dëmin bazuar në vlerën fer të instrumentit, nëse ekziston çmimi i dallueshëm i tregut. Nëse pasuria kolateralizohet dhe heqja e së drejtës mbi hipotekën është e besueshme, atëherë mbajtësi mat dëmin duke u bazuar në vlerën fer të kolateralit. Pasuria është kolateralizuar nëse borxhliu e ka lënë peng një pasuri që mund të merret, nëse borxhliu nuk ia kryen pagesat kreditorit. Heqja e së drejtës mbi hipotekës është proces me të cilin kredituesi merr në posedim pasurinë e përdorur si kolateral i borxhit.
56. Nëse në periudhën pasuese, shuma e dëmit ose humbja e borxhit të keq zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me ngjarjen e ndodhur pas regjistrimit (siç është përmirësimi në pozitën financiare të borxhliut), regjistrimi i pasurisë financiare duhet të kthehet ose drejtpërdrejt ose duke e harmonizuar me një llogari shtesë. Kthimi prapa nuk duhet të rezultojë me shumën e regjistrimit të pasurisë financiare që tejkalon atë që do të mund të ishte kostoja e amortizimit, nëse dmëi nuk është njohur në datën kur zvogëlimi i pasurisë financiare është kthyer prapa.
57. Shuma e regjistrimit e çdo pasurie financiare që nuk është regjistruar në vlerën fer, sepse vlera e saj fer nuk mund të matet me besueshmëri, duhet të rishqyrtohet për ta shënuar dëmin në secilën datë të pasqyrës së bilancit. Nëse ekziston shënimi i dëmit, shuma e humbur e dëmit të humbur të pasurisë së tillë financiare, është ndryshimi midis shumës bartëse të saj dhe shumës së rikuperueshme.

Shpalosja

58. Qëllimi i shpalosjes së kërkuar me këtë standard është sigurimi i informatës që do ta shtojë të kuptuarit e rëndësisë së instrumenteve financiare të pozitës financiare të ndërmarrjes, performancës dhe rrjedhave të parasë dhe të ndihmojë vlerësimin e shumave, kohëzgjatjen dhe sigurinë e rrjedhave të parasë në të ardhmen, përkitazi me këto instrumente.

59. Transaksionet në instrumentet financiare mund të rezultojnë me një ose më shumë rreziqe financiare të supozuara të ndërmarrjes, të përshkruara më poshtë. Shpalosjet e kërkuara sigurojnë informatë që i ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare për vlerësimin e shkallës së rrezikut lidhur me të dy instrumentet financiare: si ato të njohura, ashtu edhe ato të panjohurat.
- (a) rreziku i çmimit - ekzistojnë tri lloje të rrezikut të çmimit: rreziku valutor, rreziku i shkallës së interesit dhe rreziku i tregut.
 - (i) rreziku valutor është rreziku se vlera e instrumentit financiar do të lëvizë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit.
 - (ii) rreziku i shkallës së interesit është rreziku se vlera e instrumentit financiar do të lëvizë për shkak të ndryshimeve në shkallët e interesit të tregut
 - (iii) rreziku i tregut është rreziku se vlera e instrumentit do të lëvizë si rezultat i ndryshimit në çmimin e tregut. Këto ndryshime mund të shkaktohen nga faktorët specifik për sigurinë individuale ose nga emetuesit e tij ose nga faktorët që ndikojnë në të gjitha letrat me vlerë të tregtueshme në treg.
 - (b) rreziku kreditor - rreziku kreditor është rreziku që njëra palë në instrumentin financiar do të dështojë në shkarkimin e obligimit dhe do t'i shkaktojë humbje financiare palës tjetër.
 - (c) rreziku i likuiditetit - rreziku i likuiditetit – gjithashtu i referuar edhe si rrezik financimi - është rreziku që një ndërmarrje do të ndeshet me vështirësi në shtimin e fondeve për t'i përmbushur zotimet e shoqëruara me instrumentet financiare.
 - (d) rreziku i rrjedhës së parasë - rreziku i rrjedhës së parasë është rreziku se rrjedha e parasë, e shoqëruar me instrumentin financiar monetar, në të ardhmen do të lëvizë në shumë.
60. Kur instrumentet financiare mbahen ose emetohen nga ndërmarrja ose veç e veç ose si klasë, krijohet mundësia për një ekspozim më të madh potencial ndaj rreziqeve të përshkruara në paragrafin 59, afatet dhe kushtet vijuese duhet të shpalosen:
- (a) shuma dhe koha e planifikuar e arkëtimit ose pagesave në para të gatshme në të ardhmen të kryegjësë, përfshirë pagesat e kështit

- (b) shkalla e caktuar ose shuma e interesit, dividendi ose fitimin tjetër periodik i kryegjësë dhe i pagesave me kohë
- (c) kolaterali i mbajtur, në rast të pasurisë financiare, ose i lënë peng me rastin e detyrimit financiar
- (d) në rastin e instrumentit për të cilin rrjedha e parasë emërtohet në valutë të huaj, valutë në të cilën kërkohen arkëtimet **ose pagesat**.

Rreziku i normës së interesit

61. Për çdo lloj të pasurisë financiare dhe detyrimit financiar: të njohura e të panjohura, ndërmarrja duhet ta shpalosë informatën rreth ekspozimit të tij ndaj rrezikut të shkallës së interesit, përfshirë:
- (a) datat kontraktuese të skadimit, dhe
 - (b) shkallët efektive të interesit, kur janë të zbatueshme
62. Informata rreth datave të skadimit tregon kohëzgjatjen për të cilin shkallët e interesit janë fikse dhe informata rreth shkallës efektive të interesit i tregon nivelet në të cilat ato janë fikse. Shpalosja e kësaj informate përdoruesëve u siguron pasqyra financiare me bazë për vlerësimin e rrezikut të çmimit të shkallës së interesit që i ekspozohet ndërmarrja dhe si rrjedhim, potencialin për fitimin ose humbjen.

Rreziku kreditor

63. Për çdo lloj të pasurisë financiare: të njohur dhe të panjohur, ndërmarrja duhet të nxjerr në pah informatën rreth ekspozimit të saj ndaj rrezikut kreditor, përfshirë:
- (a) shumën që më së miri përfaqëson ekspozimin ndaj rrezikut kreditor maksimal në pasqyrën e bilancit, pa marrë parasysh vlerën fer të ndonjë kolaterali, në rast se palët e tjera nuk i kryejnë obligimet e tyre sipas instrumenteve financiare, dhe
 - (b) Përqendrimet e mëdha të rrezikut kreditor
64. Ndërmarrja siguron informatë lidhur me rrezikun kreditor për t'u lejuar përdoruesve të pasqyrave të saj financiare për të vlerësuar kohën deri kur dështimet e kundërpalëve për të shkarkuar obligimet e tyre, mund ta zvogëlojnë shumën e hyrjes së parave të gatshme në të ardhmen nga pasuria financiare në pasqyrën e bilancit. Dështimet e tilla shtojnë humbjen financiare të njohur në pasqyrën e të ardhurave të një ndërmarrjeje.

65. Në rastin e pasurisë së njohur financiare që u ekspozohet rreziqeve, siç janë të arkëtueshmet, shuma e regjistruar e pasurisë në pasqyrën e bilancit neto nga ndonjë rezervë e zbatueshme për humbje, zakonisht përfaqëson shumën e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor.
66. Kur ekspozimi maksimal është i barabartë me kryegjënë - të caktuar, nominale ose shuma tjera të ngjashme kontraktuese të instrumentit - lidhur me ekspozimin kreditor nuk kërkohet shpalosje shtesë.
67. Përqendrimet e rrezikut kreditor shpalosen, kur nuk janë të dukshme nga shpalosjet e tjera rreth llojit dhe pozitës financiare të biznesit, dhe ato rezultojnë me ekspozimin e madh për humbje në rast të dështimit nga palët e tjera. Identifikimi i përqendrimeve të mëdha është çështje e gjykimit të menaxhmentit, duke i marrë parasysh rrethanat e ndërmarrjes dhe borxhlinjve të saj. Përqendrimet e rrezikut kreditor mund të ndodhin si shkak i ekspozimit të një borxhliut të vetëm ose të grupit të borxhlinjve, me karakteristika të tilla të ngjashme që aftësia e tyre për t'i përmbushur obligimet e tyre, pritet të ndikohet ngjashëm nga ndryshimet ekonomike ose kushtet e tjera. Karakteristikat që mund ta shtojnë përqendrimin e rrezikut, përfshijnë llojin e aktiviteteve që ndërmerret nga borxhlinjtë, si industria në të cilën ata veprojnë dhe hapësira gjeografike në të cilën ndërmerren aktivitetet. Përqendrimet e rrezikut kreditor, po ashtu, mund të krijohen nëse nga ndërmarrja mbahet një shumë e madhe e investimeve nga emetuesi i njëjtë.

Shembujt

1. Ndërmarrja prodhuese ia shet një përqindje të madhe të prodhimit të saj klientit të posaqëm. Si rezultat, përqindje e madhe përkatëse (më tepër se 10%) e saldos së kontove të arkëtueshme të ndërmarrjes janë borxhe nga klienti i njëjtë. Ky është përqendrimi i rrezikut kreditor të ndërmarrjes që nuk është i dukshëm në pasqyrat financiare dhe duhet të shpaloset.

2. Furnitori i pajisjes shet kryesisht për klientët në industrinë e naftës dhe të gazit. Po ashtu, shuma e kontove përkatëse të arkëtueshme nga klienti individual nuk është e madhe, furnitori ka një ekspozim të rrezikut kreditor të tërësishëm nga klientët në industrinë e naftës dhe gazit pasi rreziku i mospagesës ndikohet nga ndryshimet ekonomike në të njejtën industri. Përqendrimi i rrezikut kreditor të furnitorëve nuk është i dukshëm në pasqyrat financiare dhe duhet të shpaloset. Ky është ekspozimi kreditor maksimal i kontove të arkëtueshme nga klientët e industrisë së naftës dhe të gazit.

68. Shpalosja e përqendrimeve të rrezikut kreditor përfshin përshkrimin e karakteristikave të ndara që identifikon çdo përqendrim dhe shumë të ekspozimit maksimal të rrezikut kreditor të shoqëruar me të gjitha pasuritë financiare të njohura dhe të panjohura që përbëjnë atë karakteristikë.

Vlera fer

69. Metodatat dhe supozimet e rëndësishme të aplikuara në vlerësimin e supozuar të vlerave fer të pasurive dhe të detyrimeve financiare që regjistrohen në vlerën fer, duhet të përfshihen në shpalosjet e politikave kontabël të ndërmarrjes. Kjo shpalosje duhet të kryhet ndaras për llojet e rëndësishme të pasurive financiare.

Shpalosjet e tjera

70. Pasqyrat financiare duhet t'i përfshijnë të gjitha shpalosjet vijuese shtesë lidhur me instrumentet financiare:
- (a) Nëse supozimi se vlera fer mund të matet në mënyrë të besueshme për të gjitha pasuritë financiare që janë të gatshme për shitje ose mbahen për tregti, kanë qenë fituar dhe, si pasojë, ndërmarrja është duke matur ndonjë pasuri të tillë financiare me koston e amortizuar, shpalos atë fakt së bashku me përshkrimin e pasurisë financiare, shumën e regjistrimit të tyre, një sqarim se pse vlera fer nuk mund të matet me besueshmëri dhe, nëse është e mundshme, shkallën e vlerësimeve të supozuara brenda së cilës duket se shtrihet vlera fer. Më tej, nëse pasuritë financiare, vlera e të cilave më parë nuk ka pasur mundësi të matej me besueshmëri, dhe i është shitur, ky fakt, shuma e regjistrimit të pasurisë së tillë financiare në kohën e shitjes dhe shuma e fitimit ose humbjes së njohur, duhet të shpalosen.
 - (b) T'i shpalosë zërat e mëdhenj të së ardhurës, shpenzimit, fitimeve dhe të humbjeve që rezultojnë nga pasuritë dhe detyrimet financiare, qoftë e përfshirë në fitimin ose humbje neto ose si komponent i ndarë i ekuitetit. Për këtë qëllim:
 - I. të hyrat totale të interesit dhe shpenzimi total i interesit (të dyjat në bazë të çmimit historik) duhet të shpalosen ndarazi.
 - II. sa u përket pasurive financiare të gatshme për shitje që janë harmonizuar në vlerën fer pas marrjes fillestare, fitimet dhe humbjet totale nga mosnjohja e pasurive të tilla financiare të përfshira në fitimin ose humbjen neto për periudhë, duhet të raportohen ndarazi nga fitimet dhe humbjet totale nga vlera fer e harmonizuar e pasurive dhe e detyrimeve të njohura të

përfshira në fitimin ose humbjen neto për periudhën. Nuk kërkohet shpalosje e ngjashme e fitimeve dhe humbjeve “të realizuara” kundrejt “të perealizuarave” në lidhje me pasuritë dhe detyrimet financiare të mbajtura për tregti.

- III. ndërmarrja duhet ta shpalosë shumën e së ardhurës nga interesi që ka qenë përlogaritur (akruar) në huanë e dëmtuar dhe që nuk ka qenë pranuar ende në para të gatshme.
 - IV. Nëse ndërmarrja ka riklasifikuar se pasuria financiare, kërkohet të raportohet në koston e amortizimit më tepër se në vlerën fer, duhet shpalosur arsyeja për atë riklasifikim.
 - V. Shpalos llojin dhe shumën e çdo humbjeje nga dëmi apo duhet kthimi prapa i një njohjes së një humbjeje nga dëmi e njohur për pasuri financiare, ndaras për çdo klasë të madhe të pasurisë financiare.
 - VI. Huamarrësi duhet ta shpalosë shumën e regjistrimit të pasurisë financiare të lënë peng si kolateral për detyrimet dhe çfarëdo marrëdhëniesh a kushtesh të rëndësishme lidhur me pasuritë e lëna peng.
- VII. Huadhënësi duhet të shpalosë:
- i. Vlerën fer të kolateralit (pasuritë financiare dhe jofinanciare) që është pranuar dhe që është lejuar për t'u shitur ose për t'u rilënë peng në mungesë të pagesës
 - ii. Çfarëdo marrëdhëniesh a kushtesh të rëndësishme të shoqëruara me përdorimin e tij me kolateral

Data e hyrjes në fuqi dhe tranzitorja

- 71. Ky standard fuqizohet për pasqyrat financiare duke mbuluar periudhën që nga 1 janari i vitit 2002 e tutje.
- 72. Kalimi në këtë standard duhet të bëhet kështu:
 - (a) Njohja, mosnjohja dhe matja e politikave kontabël, e përcjellë në pasqyrat financiare për periudhat para datës së hyrjes në fuqi të këtij standardi, nuk duhet të ndryshojnë dhe, si rrjedhim, këto pasqyra financiare nuk duhet të rishpallen.
 - (b) Në fillim të vitit financiar, në të cilin ky standard aplikohet fillimisht, ndërmarrja duhet t'i aplikojë kriteret për t'i identifikuar ato pasuri dhe

detyrime financiare që duhet të maten në vlerën fer dhe ato që duhet të maten me koston e amortizimit dhe ajo duhet t'i rima së ato pasuri si duhet. Çdo harmonizim i shumës së regjistrimit më përpara duhet të njihet si harmonizim i bilancit të fitimeve të pashpërdara në fillim të vitit financiar, në të cilin ky standard është aplikuar fillimisht.